

"STATUT I SHOQERISE"
"Perfect Way" SH.P.K

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dhe/ose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 18/11/2021, personi i meposhtem:

Z. Zihni Topuzi shtetas shqiptar, lindur me 19/05/1986 ne Lugjë, (ALB) e banues ne Shqiperi, mbajtes i kartes se identitetit me nr. I60519082M, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar;

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratoi kete Statut si vijon:

Ne kete statut

- "Ligi" eshte Ligji 9901/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" eshte ky Statut i Shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Kreu II

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 18/11/2021 une, themeluesi i mesiperm, vendosa te krijoi nje shoqi me perqejjesi te kufizuar me emrin dhe emertimin tregtar " Perfect Way " SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Shoqeria do te kete si aktivitet: Marketing online dhe studime tregu si edhe cdo veprimtari tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.



Neni 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar dhe /
ose e pakufizuar,

Neni 4
Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga e Kavajes 103, Tiranë, Shqiperi. Me vendim te Administratorit,
Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes Shqiperise.

Kreu II
Kapitali

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 LEKE (njeqind leke) dhe zoterohet teresisht nga
ortaku themelues zoterues i l(nje) kuote me vlore te per gjithshme (100 lek), qe perben
100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut eshte ne para.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar
per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata
kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kereses se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin
themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe
kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejen mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet: kontributit ne kapitalin e shoqerise; shitblerjes; trashegimise; dhurimit; cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Cdo disponim ne favor te nje pale te trete nepermjet veprimeve juridike ndermjet te gjalleve duhet te behet ne forme noteriele dhe te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjeseve te kapitalit me kundersherblim, ortaket e tere kane te drejten e parablerjes. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshrne me rruge trashegimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organ Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperieve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personal e permendor ne shkronjat "c" dhe "c" te kesaj pike;
- dh) mbikryqjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorret, perfshire perqatijen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhc te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) persaqesimin e shoqerise ne gjykates dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- j) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te persaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproe si persaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme,

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite,

Per sa kohe qe kapitali themeltar i Shoqerise zoterohet nga nje ortak i vetem, ky i fundit do te ushtruje kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

Neni 9

Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike, Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes I te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise,

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 le ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mijete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelinin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Neni 12
Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13
Administrimi

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riperterite. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i me positem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandati 5(pese) vjear emerimi: Z. Zihni Topuzi shtetas Shqiptar, lindur me 19/05/1986 ne "Lugjej" e banues ne Shqiperi, mbajtes i kartes se identitetit me nr.I60519082M, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar.

Kreu IV
Viti finanziar-ekspertet

Neni 14
Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar filion nga data e regjistrirnit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 15
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollot periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tillle i ngarkuar nga ana e ortakeve.
Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar per gatit raportin me shkrim per nxjenjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollot periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe fia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja - Riorganizimi i Shoqerise

Neni 16
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe: kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; me vendim te Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave te falimentimit; ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; me vendim te gjykates, Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar I apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper". Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftezie paguese, me perjashtir te rasteve kur eshte nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaket, Nese Ortaket nuk marrin një vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar një likuidues.

Neni 17
Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 dale 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 18
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar, Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfarcdo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.



Neni 19
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nenshkrua nga ortaku themelues si vijon:

ORTAKU THEMELUES
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" Perfect Way" SHPK
Z. Zihni Topuzi

Zihni Topuzi 

Faqe 7 nga 7

